

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “TOWER” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-05904-05-21-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti I: Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rrugët Marie Kraja - Kokonozët - Zana Floqi - Filip Shiroka”

Fondi limit: 985,734.26 (nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024, miratuar me VKB Nr.125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: 7 (shtatë) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.06.2024 ora 11:00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.27 datë 27.05.2024,

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk **NUIS K72113010E**
Vlera e ofertës = **825,000** (tetëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “INFRATECH” shpk **NUIS K91628001D**
Vlera e ofertës = **865,758** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “FTA Studio shpk & ZENIT&CO” shpk **NUIS L72411026N; K61731002D**
Vlera e ofertës = **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik “GB Civil Engineering” shpk **NUIS L51825011V**
Vlera e ofertës = **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik “NET-GOUP” shpk **NUIS L72023002P**

Vlera e ofertës = **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

6. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk **NUIS L01717030C**
Vlera e ofertës = **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomik “TOWER” shpk **NUIS L21717003H**
Vlera e ofertës = **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

8. Operatori Ekonomik “PROJECT DALUZ 2019” shpk **NUIS L92112031B**
Vlera e ofertës = **865,995.58** (tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “SPHAERA shpk & ARKIMADE” shpk **NUIS J81809003U; L01906030A**
Vlera e ofertës = **866,708.57** (tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik “A & E ENGINEERING” shpk **NUIS K72113010E**
Arsyet:

Operatori ekonomik A & E ENGINEERING sh.p.k nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: *"Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave per Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".*

Operatori Ekonomik “INFRATECH” shpk **NUIS K91628001D**
Arsyet:

Operatori ekonomik “INFRATECH shpk, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: *"Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave per Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".*

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “FTA Studio shpk & ZENIT&CO” shpk **NUIS L72411026N; K61731002D**

Arsyet:

Operatori ekonomik ZENIT&CO shpk ka paraqitur në sistemin elektronik të APP ISO 14001-2015 e cila figuron evlefshme deri më datë 20.04.2024, ndërkohë që procedura e prokurimit për këtë objekt është zhvilluar më datë 03.06.2024, gjë e cila bie në kundërtim me pikën 6/ c të kriterëve të vecanta për kualifikim në DST.

Bashkimi i operatorëve ekonomik FTA Studio shpk & ZENIT&CO shpk nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: *"Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim".*

Operatori Ekonomik "PROJECT DALUZ 2019" shpk

NUIS L21717003H

Arsyet:

Operatori ekonomik "PROJECT DALUZ 2019" në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar stafin inxhinierik vetëm me emër, mbiemër gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 4 të DST ku citohet se: Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka leshuar kete dokument.

Operatori ekonomik PROJECT DALUZ 2019 shpk në Formularin e vetëdeklarimit shtojca 9 nuk ka deklaruar punonjës të pajisur me certificate kërkuar sipas pikës 5 të kriterëve të vecanta për kualifikim ku citohet, Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a. 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", ...
- b. 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhytjen ndaj emergjencave"

1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier",

Operatori Ekonomik "NOVATECH STUDIO" shpk

NUIS L01717030C

Arsyet:

Në dokumentacionin e paraqitur nga Operatori ekonomik NOVATECH STUDIO shpk hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr.24529 Prot., datë 24.06.2024 konkludon se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit.

Operatori ekonomik NOVATECH STUDIO shpk ka paraqitur dokumentacion për Z.R. Kodra specialist "Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim" i cili nuk figuron në listpagesat e shoqërisë, gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 5/b të kriterëve të veçanta për kualifikim të kapacitetit teknik në DST.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori ekonomik NOVATECH STUDIO shpk rezulton se kontrata e punës për Z.R. Kodra specialist "Ekspert Zjarrefikes në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim" është fotokopje e panoterizuar gjë e cila bie në kundërshtim me kërkesat e DST.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Operatori ekonomik NOVATECH STUDIO shpk rezulton se nuk ka paraqitur formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore, gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim të kapacitetit teknik në DST.

Pas hedhjes së shortit për ofertuesit e kualifikuar me vlerë të njëjtë ndërmjet, Operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” shpk, Operatorit ekonomik “TOWER” shpk dhe Operatorit ekonomik “NET-GOUP” shpk rezultoi të shpallet fitues Operatori ekonomik “TOWER” shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“TOWER” shpk**, me adresë Njesia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9, nr.pasurie 6/544+2-P, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **865,955.75** (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 865,955.75 (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar).

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____